



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.112

12 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.553, datë 11.8.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”	4429
Vendim i KM nr.554, datë 11.8.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar	4433
Vendim i KM nr.555, datë 11.8.2011	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura	4435
Vendim i KM nr.556, datë 11.8.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.1061, datë 8.7.2010 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”	4451
Vendim i KM nr.557, datë 11.8.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme”, të ndryshuar	4453
Vendim i KM nr.558, datë 11.8.2011	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar	4454

Vendim i KM nr.559, datë 11.8.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.413, datë 26.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës, si dhe të strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të autoritetit të Aviacionit Civil”, të ndryshuar	4456
Vendim i KM nr.560, datë 11.8.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.438, datë 13.7.2007 “Për pagat e punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, të ndryshuar	4457
Vendim i KM nr.561, datë 11.8.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.432, datë 13.7.2007 “Për klasifikimin e funksioneve, trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, të ndryshuar	4458

VENDIM
Nr.553, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1619, DATË 2.7.2008
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN
E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFIJVE
TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe të neneve 24, 32 e 54 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “a” deri në “e” të pikës 1 të vendimit, ndryshohen si më poshtë vijon:

“a. Për Bashkinë e Tiranës:

- Kryetari	138 750 - 173 400 lekë;
- Nënkyetari	130 000 - 138 750 lekë.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë:

- Kryetari	92 000 - 138 750 lekë;
- Nënkyetari	60 000 - 92 000 lekë.

c) Për njësitë e qeverisjes vendore me 50 001 - 100 000 banorë:

- Kryetari	60 000 - 115 000 lekë;
- Nënkyetari	49 000 - 90 000 lekë.

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore me 20 001 - 50 000 banorë:

- Kryetari	51 000 - 90 000 lekë;
- Nënkyetari	41 000 - 77 000 lekë.

d) Për njësitë e qeverisjes vendore me 5 001 - 20 000 banorë:

- Kryetari	41 000 - 77 000 lekë;
- Nënkyetari	28 000 - 68 000 lekë.

dh) Për njësitë e qeverisjes vendore me nën 5 000 banorë:

- Kryetari	37 000 - 54 000 lekë;
- Nënkyetari	27 000 - 42 000 lekë.”.

b) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Bashkisë së Tiranës”, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave”, që përmendet në pikën 3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Lidhja nr.3 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të këshillit të qarkut”, që përmendet në pikën 4, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Lidhja nr.7, që përmendet në pikën 5, zëvendësohet me lidhjen numër nr.6, “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

dh) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Shtesa për kualifikim (kolona 4 e lidhjeve nr.1 dhe nr. 3) është 0.”.

e) Lidhja nr.5 “Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë të bashkive e të komunave”, që përmendet në pikën 13, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ë) Në pikën 18, vlera “... 31000 lekë në muaj”, bëhet “...32000 lekë në muaj”.

f) Në pikën 19, vlera “... nga 19 000 deri në 31 000 lekë në muaj”, bëhet “... nga 20 000 deri në 32 000 lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2011, do të përballohen nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

		PAGA MUJORE			
Klasa	Kategoritë	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%	0	Nga 69.000 deri 117.300
II	II-a	1	2%	0	Nga 66.000 deri 107.100
	II-b	1	2%	0	Nga 58.000 deri 89.800
III	III-a	1	2%	0	Nga 32.000 deri 72.500
	III-a/1	1	2%	0	Nga 29.000 deri 63.300
	III-b	1 ose 2	2%	0	Nga 27.000 deri 55.100
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 25.000 deri 43.900
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 33.700

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË E TJERA, NJËSITË BASHKIAKE TË TIRANËS DHE NËPUNËSIT E KOMUNAVE

Klasa	Kategoritë	PAGA MUJORE (LEKË)						
		Paga individuale		Shtesa e pozicionit				
				Njësi të qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 50001- 100 000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 20001-50 000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 5001-20 000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me më pak se 5000 banorë
	1		2	4	5	6	7	8
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi në punë	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%	Nga 25.000 deri 67.360	Nga 22.200 deri 60.770	Nga 20.600 deri 49.450	Nga 19.600 deri 34.500	Nga 17.000 deri 28.900
II	II-a	1	2%	Nga 24.000 deri 63.850	-	-	-	-
	II-b	1	2%	Nga 20.600 deri 54.400	Nga 19.600 deri 49.450	Nga 17.000 deri 39.700	Nga 16.500 deri 34.000	Nga 16.000 deri 26.100
III	III-a/1	1	2%	Nga 20.000 deri 48.400	Nga 18.600 deri 43.300	Nga 16.700 deri 37.600	Nga 15.500 deri 30.400	Nga 15.000 deri 25.300
	III-b	1 ose 2	2%	Nga 19.600 deri 44.100	Nga 17.000 deri 40.700	Nga 16.300 deri 35.500	Nga 15.000 deri 28.300	Nga 14.000 deri 24.750
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	Nga 13.000 deri 31.500	Nga 13.000 deri 29.400	Nga 12.000 deri 28.300	Nga 12.000 deri 26.800	Nga 12.000 deri 21.200
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	Nga 12.000 deri 28.850	Nga 11.500 deri 25.750	Nga 11.500 deri 21.650	-	-

Shënim. Këshilli i bashkisë dhe komunës në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion, sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të Regjistrit të Gjendjes Civile, në fillim të vitit kalendarik.

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

Klasa	Kategoritë	Paga mujore (lekë)			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	1	2%	0	Nga 36.000 deri 73.150
II	II-a	-	-	0	-
	II-b	1	2%	0	Nga 23.500 deri 55.600
III	III-a/1	1	2%	0	Nga 23.500 deri 48.400
	III-b	1 ose 2	2%	0	Nga 19.000 deri 44.300
IV	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 13.000 Deri 34.000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 12.500 Deri 25.500

STRUKTURA DHE KUFIJTË E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BASHKIVE E TË KOMUNAVE

Emërtesa	Paga (lekë /muaj) nga	deri
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	73 440	83 640
Kryeinspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50 000 banorë	58 140	66 300
Kryeinspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	44 880	49 980
Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	58 140	66 300
Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50 000 banorë	40 800	45 900
Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	34 680	39 780
Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	44 880	49 980

Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, me mbi 50 000 banorë	34 680	39 780
Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50000 banorë	32640	37740
Punonjës i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, deri në 5001 banorë	29580	32640

Lidhja nr.6

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND); Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND); Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	13000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP); Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10000 lekë

VENDIM

Nr.554, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në pikën 2/I, vlera 12 000 lekë bëhet 13 000 lekë.
 - c) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Punonjësit mësimorë që punojnë brenda rrethit të tyre jashtë qendrave urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, përfitojnë shpërblim deri në 1800 lekë në muaj.

Punonjësit mësimorë që punojnë brenda rrethit të tyre jashtë qendrave urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre përfitojnë shpërblim deri në 5250 lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
		1	2	3	4
1	Drejtor i shkollës së mesme; Drejtor i Institutit të Nxënësve që nuk Shikojnë; Drejtor i Institutit të Nxënësve që nuk Dëgjojnë; Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore; Drejtor i konvikteve	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	50000
2	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme. Përgjegjës i bazës prodhuese; Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë; Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë; Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	45000
3	Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	42500
4	Drejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	41000
5	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV; Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive; Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	38300
6	Drejtor i kopshtit me ushqim; Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	37000
8	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	34000
9	Mësues në shkollat e mesme; Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë; Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë; Mësues në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	36000
10	Inspektor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	34500
11	Mësues në shkollat 9-vjeçare, klasa I-IX;	1 ose	2% e PG	5 % e PG	33000

	Edukator konvikti; Kujdestar konvikti	2		10% e PG 20% e PG	
12	Edukator në kopsht fëmijësh	1 ose 2	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	30000
13	Mësues	2 ose 3	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	27000
14	Edukator në kopsht fëmijësh	2 ose 3	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	25500

VENDIM
Nr.555, datë 11.8.2011

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË
MBROJTJES, TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË
SË SHËNDETËSISË E MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE PËR TRAJTIMIN E
MJEKËVE NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:
 - a) mjekët dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë;
 - b) mjekët dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë, civilë në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes;
 - c) infermierët e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë;
 - ç) infermierët e sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit me arsim të lartë, të përmendur në pikën 1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij vendimi, caktohen sipas lidhjes nr.1 (kreu 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10) dhe lidhjes nr.2 (kreu 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
3. Paga e grupit, kolona 1:
 - a) e lidhjes nr.1, diplomë e shkollës së lartë, është 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj;
 - b) e lidhjes nr.2 përcaktohet sipas lidhjes nr.3, bashkëlidhur këtij vendimi.
 - “Paga e grupit 1” u jepet punonjësve me diplomën e shkollës së lartë të infermierisë.
 - “Paga e grupit 2” u jepet punonjësve me:
 - a) diplomë të shkollës së mesme mjekësore;
 - b) diplomën e shkollës së mesme dhe dëshminë e kualifikimit të kurseve 1- dhe 2-vjeçare, për degën infermier/mami, ndihmësinfermier/ndihmësmami.
 - “Paga e grupit 3” u jepet punonjësve me arsim nëntëvjeçar.
4. Shtesa për vjetërsi në punë, kolona 2, e lidhjeve përkatëse, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
5. Shtesa për kualifikim, kolona 3 e lidhjeve përkatëse është 0.
6. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1 dhe të lidhjes nr.2.
7. Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 5 të lidhjes nr.1 dhe të lidhjes nr.2.

8. Punonjësve civilë me arsim të lartë në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, u jepet një shtesë, për natyrë të veçantë pune, në masën 30 për qind mbi pagën e grupit.

9. Mjekët dhe punonjësit e infermieristikës, që punojnë larg vendbanimit, marrin shpërblim mujor në masën si më poshtë vijon:

9/1 Për mjekët:

a) kur punojnë në rrethet: Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, 4 500 lekë në muaj;

b) kur punojnë në rrethet: Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, 3 800 lekë në muaj.

9/2 Për punonjësit e infermieristikës:

a) kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës, 1 000 lekë në muaj.

b) kur nuk kthehen në vendbanim brenda ditës, 3 000 lekë në muaj.

10. Për punonjësit e personelit mjekësor që nuk janë efektivë me kohë të plotë në qendrat spitalore e shëndetësore të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë e të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, për shërbimin që kryejnë në këto qendra, kontrahohen me orë pune të caktuara. Vlera e pagesës së një ore pune të kontraktuar është e njëjtë me vlerën orare të pozicionit të punës, për të cilin është kontraktuar.

11. Mjekët e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekët civilë të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilët kryejnë specializimin në qendrat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit, të paguhen në masën 80 për qind të pagës së mjekut të fushës në të cilën kryhet specializimi.

12. Për kryerjen e shërbimit të rojës, të gatishmërisë dhe urgjencës, të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekëve, civilë e ushtarakë, të strukturave të Forcave të Armatosura u jepet shpërblim si më poshtë vijon:

12/1 Për mjekët:

a) Për çdo shërbim rojë 24 orë pa ndërprerje u jepet një shpërblim:

Në qendrat spitalore universitare:		
	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
- për ditët e zakonshme	3 000 lekë	2 800 lekë
- për ditët e shtuna	3 500 lekë	3 200 lekë
- për ditët e diela e festat	4 000 lekë	3 800 lekë
Në institucionet e tjera:		
	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
- për ditët e zakonshme	2 800 lekë	2 600 lekë
- për ditët e shtuna	3 000 lekë	2 800 lekë
- për ditët e diela e festat	3 500 lekë	3 300 lekë

b) Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës u jepet një shpërblim në masën:

	Në ditët e zakonshme	Të shtuna	Të diela dhe festa
- për sistemin 24 orë	2 300 lekë	2 400 lekë	2 700 lekë
- për sistemin 16 orë	2 000 lekë	2 300 lekë	2 400 lekë
- për sistemin 12 orë	1 800 lekë	2 000 lekë	2 300 lekë

c) Kur thirren për raste urgjence, pasdite ose natën, nga mjeku i rojës së spitalit, për veprime diagnostikuese apo mjekuese, shpërblehen në masën 600 lekë deri në 1 000 lekë, në varësi të procedurës mjekësore që kryejnë. Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20 për qind e pagës mujore për çdo muaj.

12/2 Për punonjësit e infermieristikës:

a) Për punën e kryer nga ora 19:00 deri në 22:00 përfitojnë shtesë mbi pagë 120 lekë për çdo ditë, ndërsa për punën e kryer në intervalin 22:00 dhe 6:00 përfitojnë shtesë mbi pagë 500 lekë për çdo ditë.

b) Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, u jepet një shtesë në masën:

Në ditë	të zakonshme	të shtuna	të diela dhe festa
- për sistemin 24 orë	1 260 lekë	1 560 lekë	1 920 lekë
- për sistemin 16 orë	1 020 lekë	1 260 lekë	1 680 lekë
- për sistemin 12 orë	780 lekë	1 020 lekë	1 260 lekë

c) Për rastet kur, me kërkesë të institucionit dhe miratim të Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, laborantet e spitaleve kryejnë shërbim 24 orë, u jepet një shtesë, si më poshtë vijon:

- për ditë të zakonshme	1 300 lekë
- për ditët e shtuna	1 600 lekë
- për ditët e diela dhe festa	2 100 lekë

ç) Për raste të veçanta, kur mjeku i rojës e sheh të domosdoshme thirrjen e personelit të infermieristikës për kryerjen e ekzaminimit apo të mjekimit, ky personel shpërblehet në masën 300 lekë deri në 750 lekë, për çdo rast. Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20% e pagës mujore për çdo muaj.

12/3 Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mbrojtjes përcaktojnë kriteret dhe rregullat për dhënien e shpërblimit, sipas pikave 12/1 dhe 12/2 të këtij vendimi.

13. Mjekët me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë të qendrave spitalore e shërbimeve universitare, si dhe të klinikës stomatologjike, që gëzojnë statusin e qendrave kërkimore-shkencore, trajtohen në pagë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

14. Për çdo fluturim, pilotët dhe teknikët e Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopterë paguhen në masën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë.

15. Punonjësit e infermieristikës të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët deri në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit nr.623, datë 8.7.2010, përfitonin një pagë më të lartë sesa paga e parashikuar sipas lidhjeve përkatëse të atij vendimi, do të përfitojnë një pagë në ruajtje, por jo më shumë se një vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Paga në ruajtje llogaritet si diferencë midis pagës bruto që punonjësit përfitonin para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me pagën bruto që punonjësit do të përfitojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

16. Ky vendim nuk zbatohet për punonjësit e Institutit të Shëndetit Publik.

17. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

18. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” TIRANË, SPITALI UNIVERSITAR
OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK NR.1, NR.2 TIRANË, SPITALI UNIVERSITAR I
SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE “SHEFQET NDROQI” TIRANË, KLINIKA
STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË, SPITALI USHTARAK QENDROR
UNIVERSITAR TIRANË**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor - QSU “Nënë Tereza” Tiranë; - Spitali Universitar Obstetrik; Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë; Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” Tiranë; - Spitali i Sëmundjeve të Mushkërisë “Shefqet Ndroqi” Tiranë	13000	2%	0	107100		Nga..deri ...Lekë
2	Drejtor - Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë. Zëvendës drejtor i QSU “Nënë Tereza” Tiranë	13000	2%	0	89800		Nga..deri ...Lekë
3	Zëvendës drejtor në spitalet e tjera universitare	13000	2%	0	72500		Nga..deri ...Lekë
4	Shef shërbimi infektiv në QSUT	13000	2%	0	63300	8000	
5	Shef shërbimi; Shef i Sektorit Biomedikal	13000	2%	0	63300		Nga..deri ...Lekë
6	Shef reparti infektiv në QSUT	13000	2%	0	55100	8000	
7	Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjencë etj.); Shef i Qendrës së Gruas	13000	2%	0	55100		Nga..deri ...Lekë
8	Shef reparti/klinike reanimacioni	13000	2%	0	55100	1100	Nga..deri ...Lekë
9	Shef reparti/klinike psikiatrie	13000	2%	0	55100	5000	Nga..deri ...Lekë
10	Shef i Labororit Klinik Biokimik; Shef reparti kimioterapi; Shef laborator; Shef i Qendrës së Diagnozës; Molekulare	13000	2%	0	55100	2200	Nga..deri ...Lekë
11	Shef Reparti Rrezatimi; Shef Reparti i Kyrisë	13000	2%	0	55100	4600	Nga..deri ...Lekë
12	Shef kabineti; Shef i Qendrës së Protezimit; Inxhinier biomedikal	13000	2%	0	49000		Nga..deri ...Lekë
13	Shef sektori; Shef farmacie në solucionet e injektueshme; Biokimist në solucionet e injektueshme; Inxhinier i sistemeve të ngrohjes; Inxhinier hemodialize	13000	2%	0	49000		Nga..deri ...Lekë
14	Mjek; Stomatolog;	13000	2%	0	45000		Nga..deri ...Lekë

	Biolog, kimist, fizikan në preparatori; Mikrobiolog, parazitolog, virolog, mykolog; Përgjegjës qendre DDD; Specialist fizikulture (fizioterapi neurologji)						
15	Mjek infeksionist në QSUT	13000	2%	0	45000	8000	
16	Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale); Mjek onkolog; Mjek fizioeterapevt; Mjek obseter gjinekolog; Mjek pneumoftiziatër	13000	2%	0	45000	1100	Nga..deri ...Lekë
17	Mjek radilolog; Toksikolog, kimist,në laboratorin toksikologjik; Kimist në laboratorin biokimik; Fizikan në laboratorin biokimik; Biolog në laboratorin biokimik	13000	2%	0	45000	1600	Nga..deri ...Lekë
18	Mjek radiolog, në shërbimin infektiv në QSUT; Mjek në kabinetin e ekografisë, në Shërbimin Infektiv në QSUT	13000	2%	0	45000	8000	
19	Mjek kimioterapeut; Mjek hematolog; Mjek infeksionist; Mjek në pranim urgjence; Mjek në njësinë nozokomiale; Mjek laborator; Mjek histopatolog; Mjek në shërbimin e gjakut	13000	2%	0	45000	2000	Nga..deri ...Lekë
20	Mjek në Inspektoratin Sanitar; Inspektor sanitar; Epidemilog; Farmacist	13000	2%	0	45000	2500	Nga..deri ...Lekë
21	Farmacist në Laboratorin Toksikologjik; Mjek laborator izotopik; Fizikan, kimist laborator izotopik; Mjek në hemodinamikë; Fizikan në higjienë dhe epidemilogji; Inxh. kimist në shërbimin e higjienës në SUQU; Biokimist në shërbimin e mbrojtjes nukleare biokimike në SUQU	13000	2%	0	45000	2800	Nga..deri ...Lekë
22	Mjek anatomopatolog; Mjek anesteziat, reanimator; Mjek në pavijonin e rrezatimit; Mjek në pavijonin e Kyrisë; Specialist në qendrën e diagnozës molekulare; Fizikan kobalti	13000	2%	0	45000	3700	Nga..deri ...Lekë
23	Mjek, psikologë, punonjës socialë që punojnë në psikiatri	13000	2%	0	45000	5000	Nga..deri ...Lekë
24	Inspektor auditi	13000	2%	0	33700		Nga..deri ...Lekë
25	Specialist i lartë	13000	2%	0	31000		Nga..deri ...Lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË DREJTORITË
RAJONALE TË SHËNDETËSISË, DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE,
AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Titullar i drejtorive rajonale; Titullar në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës	13000	2%		72500	9000	Nga..deri ...Lekë
2	Drejtor dhe Kryeinspektor sanitar në drejtoritë e shëndetit publik në rrethe	13000	2%		63300	9000	Nga..deri ...Lekë
3	Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të shëndetësisë dhe drejtor i drejtorive të shëndetit publik në rrethe	13000	2%		55100		Nga..deri ...Lekë
4	Zëvendësitualltar në drejtoritë rajonale, në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës në drejtoritë e shëndetit publik në rrethe	13000	2%		55100		Nga..deri ...Lekë
5	Shef shërbimi i Kujdesit Parësor; Shef Shërbimi Urgjence; Shef Shërbimi i Mjekësisë Familjare	13000	2%		47250		Nga..deri ...Lekë
6	Shef Shërbimi i Higjienës; Shef Shërbimi i Epidemiologjisë	13000	2%		47250	9000	Nga..deri ...Lekë
7	Shef Shërbimi Stomatologjik	13000	2%		47250	3300	Nga..deri ...Lekë
8	Përgjegjës i Shërbimeve të Shëndetit Mendor	13000	2%		42000	5000	Nga..deri ...Lekë
9	Shef sektori; Shef reparti; Shef kabineti; Shef/përgjegjës laborator; Përgjegjës dispanserie	13000	2%		35700		Nga..deri ...Lekë
10	Specialist i lartë në higjienë; Specialist i lartë në epidemiologji	13000	2%		35700	7000	Nga..deri ...Lekë
11	Epidemiolog; Higjienist	13000	2%		35700	8000	Nga..deri ...Lekë
12	Inspektor stomatolog	13000	2%		35700	1100	Nga..deri ...Lekë
13	Shef reparti/laboratori në higjienë; Shef reparti/laboratori në epidemiologji	13000	2%		35700	9000	Nga..deri ...Lekë
14	Mjek; Stomatolog; Inxhinier elektrik; Kimist; Veteriner; Mikrobiolog	13000	2%		35700		Nga..deri ...Lekë
15	Mjek ftizioterapevt; Mjek kirurg;	13000	2%		35700	1100	Nga..deri ...Lekë

	Mjek ortoped; Mjek pneumoftiziatër						
16	Mjek radiolog; Mjek hematolog; Mjek onkolog	13000	2%		35700	1600	Nga..deri ...Lekë
17	Mjek, psikolog, punonjës socialë që punojnë në Shërbimet e Shëndetit Mendor	13000	2%		35700	5000	Nga..deri ...Lekë
18	Përgjegjës zyre; Revizor; Inspektor	13000	2%		35700	1100	Nga..deri ...Lekë
19	Specialist me arsim të lartë	13000	2%		28350		Nga..deri ...Lekë
20	Specialist i lartë promocioni	13000	2%		28350	4000	

Lidhja I (kreu 1.3)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË SPITALET E RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJËVE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	13000	2%		72500		Nga..deri ...Lekë
2	Shef Shërbimi në Anatomopatologji	13000	2%		55100	3500	Nga..deri ...Lekë
3	Zëvendës drejtor	13000	2%		48300		Nga..deri ...Lekë
4	Shef shërbimi	13000	2%		47250		Nga..deri ...Lekë
5	Shef Shërbimi Reanimacioni; Shef Shërbimi Infektiv; Shef Shërbimi Obstetrik Gjinekologjik; Shef Shërbimi Kirurgji; Shef Shërbimi Ortopedi	13000	2%		47250	1100	Nga..deri ...Lekë
6	Shef Shërbimi Radiologji; Shef Shërbimi Neuropsikiatri;	13000	2%		47250	1600	Nga..deri ...Lekë
7	Shef Shërbimi Psikiatri	13000	2%		47250	5000	Nga..deri ...Lekë
8	Shef reparti/klinike; Përgjegjës/shef kabini; Përgjegjës/shef laborator /Poliklinike/fizioterapi	13000	2%		35700		Nga..deri ...Lekë
9	Shef i Bankës së Gjakut; Shef Reparti Radiologjie; Shef Reparti pneumoftiziatri	13000	2%		35700	1100	Nga..deri ...Lekë

10	Shef reparti/klinike Psikiatri	13000	2 %		35700	5000	Nga..deri ...Lekë
11	Përgjegjës Laboratori Klinik Biokimik	13000	2 %		35700	2500	Nga..deri ...Lekë
12	Përgjegjës/Shef reparti Anatomopatologji	13000	2 %		35700	3700	Nga..deri ...Lekë
13	Mjek; Stomatolog; Biolog; Kimist; Fizikan; Shef sektori; Përgjegjës zyre; Inxhinier biomedical	13000	2 %		35700		Nga..deri ...Lekë
14	Mjek infeksionist; Mjek urgjence; Mjek laborator; Kimist, fizikan laborator; Kimist në Shërbimin e Gjakut	13000	2 %		35700	600	Nga..deri ...Lekë
15	Mjek onkolog; Mjek kirurg (specialitete të ndryshme kirurgjikale); Mjek hematolog; Mjek i bankës së gjakut; Mjek obstetër gjinekolog; Mjek pneumoftiziatër; Mjek fizioterapeut	13000	2 %		35700	1100	Nga..deri ...Lekë
16	Mjek radiolog	13000	2 %		35700	1600	Nga..deri ...Lekë
17	Mjek higjienist; Farmacist	13000	2 %		35700	2500	Nga..deri ...Lekë
18	Mjek anatomopatolog; Mjek anesteziolog reanimator	13000	2 %		35700	3700	Nga..deri ...Lekë
19	Mjek,psikolog,punonjës socialë që punojnë në Psikiatri	13000	2 %		35700	5000	Nga..deri ...Lekë
20	Specialist i lartë	13000	2 %		28350		Nga..deri ...Lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	13000	2%		72500		Nga..deri ...Lekë
2	Zëvendësdyrejtor	13000	2%		63300		Nga..deri ...Lekë
3	Shef sektori në sektorët për kontrollin e barnave	13000	2%		55100		Nga..deri ...Lekë
4	Shef sektori në sektorët e tjerë	13000	2%		43900		Nga..deri ...Lekë
5	Farmacist; Analist	13000	2%		43900	4000	Nga..deri ...Lekë
6	Farmacist Inspektor për Kontrollin Farmaceutik	13000	2%		43900	5000	Nga..deri ...Lekë
7	Specialist i lartë	13000	2%		28350		Nga..deri ...Lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E
SHËRBIMEVE MJEKËSORE**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	13000	2%		59850		Nga..deri ...Lekë
